

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 nga Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11),), si dhe në bazë të nenit 50 alinea 6 nga Ligji për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “ nr.161/2019) ministri për arsim dhe shkencë e solli programin e shkurtuar për lëndën mësimore *Arsimi muzikor* për klasën e katërt të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

PROGRAM I SHKURTUAR MËSIMOR



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

ARSIMI MUZIKOR

KLASA IV

Gusht 2020

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor për vitin shkollor 2020/2021 nga nga lënda *Arsimi muzikor* për klasën e katërt të arsimit fillor nëntëvjeçar bazohet në qëllimet/rrezultatet e pritura me programin mësimor për lëndën mësimore i cili në formë të rregullt realizohet në përputhshmëri me planin mësimor.

Me programin e shkurtuar vërtetohen temat dhe njësitë mësimore që do të duhet të realizohen për 159 ditë pune mësimore, gjatë së cilës duhet ruajtur fondi i paraparë javor i paraparë në programin e rregullt, konkretisht për lëndën mësimore me 2 orë mësimore në javë janë paraparë 64 orë me program të shkurtuar.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar bazohet nga qëllimet/ rrezultatet e pritura, nocionet, metodat dhe aktivitetet të parapara në programin e rregullt mësimor.

2. Pasqyrë e temave dhe njësive mësimore

Tema 1: AKTIVITETE EKZEKUTIMI (19 ORË)

Njësi mësimore:

1. Shqiptim, ekzekutim dhe përsëritje të numratoreve.
2. Shqiptim, ekzekutim, përsëritje të numratoreve, fjalëshpejta.
3. Këndim të tërësive të shkurtra melodike sipas dëgjimit.
4. Këndim të tërësive të shkurtra melodike sipas notave, toneve dhe me kohëzgjatje dhe pushim të duhur.
5. Përpunim të këngëve për fëmijë me gjërësi do1 – do2.
6. Përpunim të këngëve artistike me gjërësi do1 – do2.
7. Përpunim të këngëve popullore me gjërësi do1 – do2.
8. Luajtje, ekzekutim të pjesëve të shkurtra me IMF (ritmike dhe melodike) sipas dëgjimit dhe notave.
9. Lëvizje ritmike muzikore (hapërim, marshim, kërcime).
10. Tanc (tance elementare për fëmijë, lëvizje elementare në valcer).
11. Njohje me vallet popullore.
12. Luajtje të valleve dhe tanceve elementare me lëvizje të ndryshme dhe në kahje, drejtime të ndryshme.
13. Të shprehurit muzikor dhe krijimtaria (lojëra muzikore dhe dramatizime).
14. Të shprehurit muzikor dhe krijimtaria e nxënësve me përdorim të elementeve të mësuara nga shkrim leximi muzikor.

Tema 2: DËGJIMI I MUZIKES (19 ORË)

Njësi mësimore:

1. Dëgjim i veprave vokale, instrumentale dhe vokale – instrumentale të ndryshme sipas karakterit dhe përmbajtjes me ritëm/dinamikë elementare dhe me ndryshim të ritmit/dinamikës.
2. Njohja e ekzekutuesve të veprës.
3. Dallimi i ritmit (i ngadalshëm, i shpejtë) dhe dinamikës (fuqishëm, ngadalë) në veprat e dëgjuara.
4. Përshkrim të karakterit të veprës së dëgjuar.
5. Muzikë nga filma vizatimor dhe artistik për fëmijë.
6. Të dalluarit e ekzekutuesve në muzikën e filmave vizatimor dhe filmave për fëmijë.
7. Të shprehurit e përjetimit personal për veprën e dëgjuar.

Tema 3: SHKRIM – LEXIMI MUZIKOR (14 ORË)

Njësi mësimore:

1. Vendosja (të shkruarit0 e toneve: la, re dhe do1 në pesëvijësh.
2. Të dalluarit e toneve: la, re dhe do1 në pesëvijësh, ushtrime për shënim të tyre në pesëvijësh.
3. Vendi i toneve: fa, si dhe do2 në pesëvijësh.
4. Ushtrime për dallim vizual të toneve: fa,si dhe do2 në pesëvijësh.
5. Të lexuarit e toneve (solmizim).
6. Ritmi: Gjysmë nota dhe pushimi (pauza), nota e plotë dhe pushimi(pauza).
7. Tempo (si shprehje profesionale), të shpejtuarit dhe të ngadalësuarit të tempos.
8. Dinamika (si shprehje profesionale), fuqizim(rritje) dhe ngadalësim të dinamikës .
9. Shenja për përsëritje.

Tema 4: KRIJIMTARIA POPULLORE MUZIKORE (12 ORË)

Njësi mësimore:

1. Krijimet muzikore popullore/folklori muzikor i maqedonëve, shqiptarëve, turqve, romëve, sërbëve, vlllehëve, boshnjakëve.
2. Njohje, këndim, dëgjim, këndim,luajtje të këngëve dhe valleve popullore të popullit të vet dhe popujve që jetojnë në shtetin tonë.
3. Krijimtaria muzikore popullore në traditën dhe zakonet e maqedonëve, shqiptarëve, turqve, romëve, sërbëve, vlllehëve boshnjakëve.
4. Njohje me zakonet,traditat më karakteristike të popullit të vet dhe të popujve që jetojnë në shtetin tonë.
5. Hulumtim individual për krijimtarinë popullore.

3. Rekomandime didaktike

Në programin e shkurtuar mësimor për lëndën *Arsimi muzikor* për klasë të katërt në arsimin fillor nëntëvjeçar janë dhënë katër tema. Pikënisje bazë për realizimin e programit të shkurtuar mësimor për lëndën arsimit muzikor është programi i rregullt mësimor (qëllimet konkrete, nocionet, aktivitetet e propozuara dhe metodat). Gjatë realizimit të tij duhet të ketë parasysh parnjohuritë e nxënësve, të arriturat, aftësitë dhe interesat e tyre. Gjatë planifikimit të aktiviteteve duhet patur parasysh edhe përgatitja dhe njohuritë e nxënësve. Përmes këtij programi është parashikuar që nxënësit të arrijnë njohuri të thelluara nga arsimit muzikor. Nxënësit nëpërmjet programit konkret mësimor kanë mundësi të zhvillojnë aftësitë e tyre muzikore. Në përmbajtjet mësimore që mundësojnë dhe ofrojnë mundësi , mësimdhënësi duhet të mundësojë zhvillim të aftësive kreative të secilit nxënës, si dhe ti nxit për punë hulumtuese , punë individuale, punë në grupe dhe në tim.

Mësimdhënësi derisa e realizon njësinë konkrete mësimore duhet të insistojë që të përfshihen të gjithë nxënësit.

Pasi të ketë përfunduar realizimi i njësisë mësimore këshillohet mësimdhënësi të bëjë vlerësimin e njohurive të arritura të nxënësve dhe te ato të nxit të tregojnë qëndrimet e tyre, mendimet për njësinë mësimore të realizuar.

Gjatë procesit mësimor të arriturat e nxënësve rregullisht përcillen dhe vlerësohen. Rekomandohet të zbatohet notimi formativ, mikrosumativ dhe sumativ i të arriturave të nxënësve.

Vërejtje: mësimdhënësit për temën dëgjim muzike në aktivitetet e tyre të shfrytëzojnë shembujt e potencuar të parapara në programin e rregullt mësimor.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në bazë të normativit për kuadër mësimor i paraparë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën mësimore *Arsimi muzikor* për klasën e katërt në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021 e miratoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Mila Carovska